



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:245897

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485732

E.nr.0094/2012

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit individual Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit L.I., me nr. personal..., me vendbanim në Skenderaj, Rr..., për borxh në shumën prej 87.07 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit L.I., me vendbanim në Skenderaj, Rr..., për borxh në shumën prej 87.07 euro (tetëdhjetë e shtatë euro e shtatë cent), për shkak të pagesës së borxhit në tërësi nga debitori.

A r s y e t i m

Gjykata me Aktvendimin E.nr.0094/2012 me dt.11.04.2012 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala me seli në Prishtinë, ndaj debitorit L.I., me vendbanim në Skenderaj, Rr..., për borxh në shumën prej 87.07 euro.

Debitori e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbaruar borxhin në tërësi, kjo dëshmohet përmes dëftesave të lëshuara nga Telekomi i Kosovës nr.73234234 e dt.21.03.2024 e cila është në shumën prej 87.07 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me numër të pagesës 19282653-2024-Skenderaj, e lëshuar nga Posta e Kosovës dt.21.03.2024.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, andaj nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
E.nr.0094/2012, me dt.21.03.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.